



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 592

Datë: 29.11.2022

PROCESVERBAL

I mbledhjes së-VII- (shtatë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI DITËS

- 1.Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit nr.02/211 datë:05.05.2022 për themelimin e vend gjuetisë në Komunën e Malishevës.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa dhe Buxhet nr.04/724 datë: 01.08.2022.
- 3.Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, për përgaditjet dimërore nëpër shkolla.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të Kryetarit për ndalimin e shërbimit me shishe (SHISHE-Llula, Nagril e të ngjajshme në largësi 500m nga objektet shkollore dhe nga 400m nga Stacioni i Autobusëve.
5. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/252 datë:23.05/2022 të parashtruar nga Besnik Bytyqi, për lejimin e ndërtimit të rrethojave të varrezave në fshatin Shkozë.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02.285 datë: 08.06.2022, e parashtruar nga Valmire Gashi nga fshati Vërmicë..
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/467 datë:10.10.2022 e parashtruar nga Avdullah Bytyqi nga fshati Turjakë.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/470 datë:11.10.2022 e parashtruar nga Dardan Zogaj nga fshati Lladroc
9. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 18.10.2022 dhe filloi në ora: 10:05. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 25 asambleistë, Kryetari drejtorë komunal përfaqësues nga Kfori Zvicëran, përfaqësues nga OSBE-ja dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Hapi mbledhjen e shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës. Prezent në sallë janë 25 asambleistë, kuorum kemi dhe mund të vazhdojmë seancën. Me leje mungon Nebih Bibaj. Kush e do fjalën jashtë rendit të ditës? Urdhëro, Mirëllinda!

Mirëllinda Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë do e ngris një çështje për asamblen komunale. Ftesa na ka ardhur me kohë të caktuar që të fillojë mbledhja në ora:09:30, ndërsa mbledhja fillon në ora:10:05. I nderuar Kryesues, merr masa dhe mbledhjet të fillojnë me kohë të caktuar sipas programit që e keni. Shqetësim tjetër është që te procesverbalet mundësisht të punësohet ose të adresohet dikush që t'i ndihmojë zonjës këtu, që procesverbalet të na vijnë me kohë. Lë të plotësohet stafi juaj dhe të na vijnë proceset me material.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Përshëndetje për të gjithë!

Dua t'i uroj të gjithë nxënësit dhe mësimmshënësit e Komunës së Malishevës për fillimin e vitit të ri shkollor, duke ju dëshiruar shumë suksese dhe punë të mbarë në procesin edukativo arsimor. Jemi në muajin tetor dhe ndryshe njihet si muaji i ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit. Javën e kaluar Komiteti për Komunitete ka mbajtur mbledhjen e shtatë të rregullt, ku kemi takuar zyrtaren për barazi gjinore Vera Bytyqin, e cila na ka njoftuar që komuna e Malishevës përherë ka shënuar aktivitete për vetëdijësim për parandalimin e kësaj sëmundje dhe sipas informatave dhe këtë vit do të zhvillohen aktivitete të ngjashme. Aparati i mamografisë është funksional në qendrën e mjeksis familjare në Malishevë, dhe në muajin tetor të gjitha gratë të cilat i kryejn kontrollat ato kontrollera do t'i kenë pa pagesë. Kërkojmë nga gratë asambleiste që të ngrisin qështjen në interes të fuqizimit të gruas, të jenë së bashku për të drejtat e grave në përgjithësi dhe të jenë bashkëpunuese me akterët relevantë. Kur jemi te sektori i shëndetësisë dua të dua të përgëzoj kryetarin Kastrati me rastin e fillimit të realizimit të programit për vizitat shëndetësore shtëpiake, për kujdesin për nënat dhe fëmijët.

Argjend Thaçi: Urdhëro Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë.

Tetori në gjithë botën është muaji i ndërmjetësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Është një fushatë vetëdijësuese që synon të shpërndaj një informacion dhe të kërkoj nga njerzit për rëndësinë e shëndetit dhe të zbulimit të hershëm të sëmundjes së kancerit të gjirit. Fatmirësisht qendra e mjeksisë "Shpëtim Robaj" i ofron mundësinë e shërbimeve mamografike. Ne si LVV që nga viti 2013 e kemi ngritur qështjen për aparatën e mamografisë, dhe në vitin 2016 është bërë

ndarja e buxhetit për blerjen e këti aparati. Është shumë mirë që kjo aparatur është në funksion dhe në muajin tetor ju ofron shërbime falas grave në përgjithësi. Ajo çka është shqetësuese që po bëhen shumë pak kontrole, kjo mungesë e kontrollave tregon që ne kemi nevojë më shumë për fushata sensibilizuese rreth kësaj qështje. Me një kuptim të thjeshtë të faqja e komunës shihet që përveq njoftimit që QKMF-ja ofron shërbime mamografike falas gjatë muajit tetore, unë nuk pashë asnjë aktivitet tjetër. Unë ju ftoj që të bëjmë më shumë në këtë drejtim në mënyr që të inkurajojmë sa më shumë gra që të bëjnë këto kontrolla.

Argjend Thaçi: Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përsëndetje për të gjithë!

Unë dhe sot do të ngris disa qështje që kanë të bëjnë me interesin qytetar, por nuk po mirren parasysh këto vrejtjet tona nga ana e qeveris. Qështja e parë që do të ngris është qështja e stacionit të autobusëve ndërmarrja e vetme e publike lokale e komunës së Malishevës. Në vitin 2016 është rikthyer me kompetenc menaxhimi i kësaj ndërmarrje por nuk kemi parë asnjë rast konkret për fuqizimin e kësaj ndërmarrje. E kemi një komision i përbër nga zyra e kryetarit dhe nga asambleistëve kemi kërkuar që të na sjellin një raport që ta dimë gjendjen se qysh e ka trashëguar kjo ndërmarrje tash në këtë legjislatur dhe hapat konkret që janë marrë për fuqizimin e kësaj ndërmarrje. Unë para pak ditësh i kam vizituar puntorët e kësaj ndërmarrje dhe ende nuk kanë një gjyrollogari bankare që t'i inkasojnë të hyrat. E kemi një projekt që komuna e ka realizu në pronën e kësaj ndërmarrje dhe ende nuk është funksionalizu. Si do ta zgjidhni këtë qështje? Është ndotja e Lumit Mirusha, ne sa herë që po e votojmë buxhetin e komunës po ndajmë mjete buxhetore për mirëmbajtje të pastrimit të Lumit Mirusha, por asnjëherë nuk është mirëmbajtje. Ti marrim disa hapa të paktën ta mirëmbajmë hapsirën urbane ku vizitorët dhe qytetarët kanë kohë të shohin diqka të mirë në qytet. Pastaj është objekti i veteranëve, kur ka me u funksionalizu ky projekt?

Qështja e ndërtimeve në Malishevë vitet e fundit po bëhen shumë ndërtime të larta dhe unë nuk kam parë ndonjë që ka bërë kërkesë për leje ndërtimi të atyre objekteve, nëse vazhdojmë kështu do të bëhet një katrahurë urbanistike.

Argjend Thaçi: Faleminderit Veton, Urdhëro Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Përsëndetje për të gjithë!

Kërkoj nga kryetari që me shqyrtu mundësin me e sjellë një njësi të stacionit Policor në Kijevë. E dimë që banorët e asaj ane janë ballafaqu me shumë probleme në të kaluarën mandej ka pasur dhe protesta dhe bllokim të rrugëve për arsye të dukurive devijante që po ndodhin dhe ky nuk është problemi i vetëm, mirëpo janë një numër i madh biznesesh që detyrohen që të bëjnë ndrrimin e natës vetë qytetarët për arsye që nuk ka stacion policor në atë pjesë. Kërkesa është që me qenë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe me qenë 24 orë, 7 ditë në javë në vëzhgim Kryetar, shpresoj këtë herë të na jepni përgjigje.

Argjend Thaçi: Urdhëro Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Në takimin e kaluar që e kemi mbajtur, keni thënë që shumë shpejtë do ta mbajmë një mbledhje urgjente që të bëhet një paraqitje të projektit për Malishevën urbane, mirëpo nuk kemi diqka të tillë. Deshta ta pyes Kryetarin a ka diqka konkrete sa i për këtë kësaj qështje, a do të mbajmë mbledhje urgjente apo jo?

Kryesues, në fshati Damanek e kemi një problem me rrjeti e rrymës që një kohë të gjatë dhe është mirë që në bashkëpunim me KEDS-in të ndërmerrni hapa për rregullimin e tyre, sepse kemi shtylla të drurit të cilat janë të vjetër dhe është rrezik për banorët.

Argjend Thaçi: Faleminderit Alban, urdhëro Halil!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Meqenëse e bëri një pyetje Vetoni që lidhet me komisioni e aksionarëve të stacionit të autobusëve dhe në cilësinë e kryetari të këtij komisioni mundem me i dhënë disa informacione. Në fillim ne jemi marrë me skanimin e gjendjes dhe me shiku që me të vërtet në atë ndërmarrje ka problematika sidomos në mandatin e kaluar qoftë prej menaxhmentit, qoftë nga komisioni i aksionarëve. Gjyrollogarin bankare të ndërmarrjes e kemi të bllokuar nga ATK, i kemi nis hapat gradual për me e rikthi në situat normale me llogari të zhbllokuara. Ne nuk kemi bërë raport para kuvendit për arsye se kemi prit me e kthi ndërmarrjen në normalitet, me i zhblloku llogarit, me e kompletu bordin dhe pastaj me raportu në kuvend, mirëpo kur do që kuvendi e kërkon një raport ne mundemi me ta bëjmë për hapat që i kemi bërë deri tani nuk është problem.

Argjend Thaçi: Urdhëro Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi: Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kam vetëm një pyetje a është nënshkruar kontrata për rregullimin dhe mirëmbajtjen e ndriqimit publik apo ende është në proces?

Cilat janë hapat që munden me u marrë për këtë qështje?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nënkryetar!

Vesel Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Fillimisht i nderumi Veton Zogaj i ngriti disa qështje dhe ne i kemi ngritur. Tek stacioni i autobusëve Halili ta dha përgjigjien shumë mirë ne e kemi formu komisionin është zgjedh bordi, bordi e ka zgjedh shefin dhe është duke u përpiluar një raport që dhe ne jemi duke e pritur si ekzekutiv në mënyrë që në bazë të atij raporti të përfundojmë obligimet ndaj APK-së për faktin që ato obligime i kanë blloku gjyrollogarit bankare të stacionit të autobusëve. Projekti për sheshin operatorit kanë planifikuar që ta inkurpurojnë në kuadër të sheshit dhe stacionin e autobusëve së pari do të jetë një rreth dhe pastaj do të bëhen disa investime. Sa i përket inkupatorit në këtë pjesë që është një investim nga ministria e industrisë dhe tregtis kanë vazhdu punimet dhe pse ka qenë kohë pandemie ka qenë nevoja e ndryshimit të disa pozicioneve të punëve shites. Të gjitha raportet ne në atë kohë i kemi pranuar por me ardhjen e ministres ne kemi pasur tri shkresa të cilat Drejtori i Urbanizmit i ka drejtuar dhe ka pasur kontakte me ministrin, por dhe me personat

përgjegjës me menagjerin e projektit dhe operatori ekonomik të cilin e kanë obliguar me i bërë ato ndryshime nuk i ka pranë ministria Hajdari. Pra, projekti ka mbetë pa u finalizuar janë dhe disa qështje të vogla të cilat duhet të përfundojnë dhe të përrurohet ai objekt, pastaj të shfrytëzohet për shërbimin të cilin është ndërtu. Te ujrat e zeza që po derdhen në Lumin Mirusha ju e dini mirë që sa vonë e kemi marrë buxhetin dhe ne kemi fillu procedurat e prokurorimit, është në procedurë të prokurorimit. Shumë shpejtë do të përfundojnë procedurat e prokurorimit dhe pastaj do të fillojmë me punimet.

Objekti i veteranëve ka fillu operatori është përzgjedhë, kontrata është nënshkruar. Te qështja tjetër që u ngritë për objektet pa leje, do të ishte më mirë i nderuari asamblist që të cekni me emër se për cilin objekt e ki fjalën, përndryshe secili objekt është me leje. Lejet nuk lëshohen në kuvend tanimë, sepse ka ndryshu ligji nëse është në përputhje me planin zhvillimor, në përputhje që ne i kemi përfundim hartat zonale ne kemi shkuar në këtë drejtim dhe ju është dhënë leja, Secili objekt që po ndërtohet ka leje ndërtimi asnjë nuk është pa leje ndërtimi.

I nderuari Labinot dhe ju i ngritët disa qështje siç ishte vendosja e një stacioni policor në Kijevë, ne e kemi pasur këtë premtim dhe gjatë fushatës. Ne kemi pasur takim pikërisht për kërkesat e qytetarëve që tju ofrojmë një siguri më të madhe për arsye se në atë zonë ka pasur vjedhje të ndryshme. Ne kemi kërkuar që ta bëjnë një ndërtim të një objekti në mënyrë që ta kemi më të sigurtë dhe ta kemi një rehabilitim pak më të mirë në këtë zonë. Ne jemi duke biseduar dhe kemi bërë një kërkesë në Ministri të punëve të mbrendshme që të na lejohet sepse ne kotë ndajmë buxhet nëse nuk na lejonë ministria e punëve të brendshme, sepse ata janë ekspertë të sigurisë dhe ata përcaktojnë se a ka nevojë apo jo. Ne jemi duke bërë vazhdimisht patrulla policore në atë zonë.

Ishte pyetja se a kemi ndarë subvencion për farë dhe plehë? Ne kemi ndarë, kanë qenë në procedurë mirë po ka pasur një ankesë nga operatorët tjerë dhe qështja është në USHP, e di që pyesin shumë fermerë për vonesa por janë procedura të tilla që nuk mundemi me i ikë. Urojmë që të paktën ta arrijmë kohën të nënshkruhet kontrata dhe të fillojmë me shpërndarjen e tyre. Pyetja tjetër është a është bërë kontrata për rregullimin dhe mirëmbajtjen e ndriqimit publik. Ne kemi pasur një takim me drejtorin e urbanizmit me nivelin qëndror apo me menaxhmentin e KEDS-it në Prishtinë në mesin e kërkesave e kemi ngritë dhe kërkesën e lagjes së re për kyqjen e rrjetit elektrik. Na është premtu në fillim të mandatit që gjatë këtij viti do ta bëjnë kyqjen. Ne kemi pasur edhe një takim tjetër është thënë që i kanë ndërpre të gjitha projektet që kanë të bëjnë me investimet kapitale. Ne nuk do të ndalemi që rrjeti në komunën e Malishevës të ndryshojë, sepse është komuna që ka rrjet më të dobët nga të gjitha komunat e Kosovës.

Pyetja tjetër ishte që Kryetari Kastrati ka premtuar që do ta sjellë projektin e sheshit para jush, jamë i sigurtë që do ta përmbajë këtë premtim. Për arsye të procedurave që duhen bërë është bërë kjo vonesë dhe besoj që së shpejti do të përfundojnë do ta nënshkruaj Kryetari dhe do të ju prezantojmë këtu para jush. E ceka dhe ndriqimin publik ne e kemi nënshkruar kontratën dhe operatori ekonomik ka fillu rregullimin e tyre fatkeqësisht shumicën e fshatrave rrjeti elektrik është duke u keq përdorë nga persona të caktuar të pandërgjegjshëm ku e shfrytëzojnë rrjetin elektrik për nevojat familjare të ndryshme e mbi ngarkon dhe vjen deri tek defekti i tyre. Ju bëjë

thirrje qytetarëve të Malishevës që mos ta keqpërdorin sepse është në të mirën e tyre. Besoj që shumë shpejtë në të gjitha fshatrat do të rinovohet ndriqimi publik sepse operatori ekonomik është duke vazhdu të bëjë punën e ti.

Argjend Thaçi: Faleminderit Nënkyetar. Fjalën e ka Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Nënkyetar, është mirë që e ceke që ka qenë premtim i partis që është në pushtet dhe i njëjti premtim ka qenë i Ministrit Sfeqla në fshatin Mleqan. Unë i di procedurat që policia është qështje e ministris së mbrendshme, por ne si komunë duhet të iniciojmë qështjet që janë në interes të qytetarëve. Do kishte me pas investime më shumë në atë zonë nëse do kishte siguri.

Argjend Thaçi: Faleminderit Labinot. Fjalën e ka Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Nënkyetari kërkojë emra për ndërtimet që po bëhen pa leje, nuk mundem me u merr me emra konkret. Nënkyetari tha që kuvendi komunal tashmë nuk lëshon leje ndërtimore, sipas statutit të komunës kuvendi komunal është ai që lëshon leje ndërtimi për secilin qytetarë apo kompani ndërtimore edhe sipas ligjit të ndërtimit kuvendi komunal është organi apo institucioni që lëshon leje ndërtimore. Nuk e di që është miratu harta zonale si dokument në kuvend, ne vazhdojmë me operu me planin zhvëllimor komunal.

Argjend Thaçi: Faleminderit Veton. Urdhëro Nënkyetar!

Vesel Krasniqi: Veton, ne për këtë arsye e kemi formu dhe është grupa punuese që ta ndryshojmë statutin dhe unë mendoj që statuti është në kuadër të kushtetutës dhe ligjit, do të ndryshohet sepse ka shkëputje me ligjin. Pjesa e ndërtimeve që është duke u bërë janë në kuadër të planit zhvëllimor dhe e ka një miratim nga e kaluara që në këtë zonë lejohen ndërtime. Nuk ka nevojë që ta bëjë një miratim të dytë nga asamblea komunale. Në përgjithësi jemi në përputhje me ligjet në fuqi nuk kan asnjë shkelje ligjore ato ndërtesa që janë duke u ndërtuar.

Argjend Thaçi: Faleminderit Nënkyetar. Kalojmë te rendi i ditës, së pari të i japim një përgjigjie asambleistes Mirëllinda Gashi për një qështje që ka ngritur në seancën e kaluar për linjën e autobusëve, operatori më ka sjellë një faktë për fshatin Vërmicë linja nisja nga Vërmica në ora 6:55, 11:55 dhe 14:20, ndërsa kthimi nga Malisheva 11:40, 14:20, 16:47 dhe 19:45 operatori në fjalë ka thënë që mbaj përgjegjësi për këtë linjë. Urdhëro Mirëllinda Gashi.

Mirëllinda Gashi: Faleminderit Kryesues për përgjigjie. Unë nuk kam cekur emra por kam folur në përgjithësi për tër fshatrat e Malishevës. Për personin në fjalë është mirë që e ka sjellur këtë përgjigjie dhe duhet secili operator me e sjell këtë listë të orareve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Linjat i lejon Drejtoria e Shërbimeve, kështu që duhet me ja kërku Drejtoris së Shërbimeve këtë listë.

Argjend Thaçi: Në seancën e kaluar Mirëllinda e ka cekur që nuk mund të paguaj 12 euro taksi nga Vërmica në Malishevë dhe operatori në fjalë e ka ndëgju këtë shqetësim dhe ma dërgoj këtë informat. Kalojmë te rendi i ditës, në këtë seancë kemi palnifikuar 9 pika gjithsej. A ka ndonjë propozim për rend të ditës?

Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Ne si grup i VV-së kërkojmë që si pikë e rendit të ditës të hyjë dhe ndryshimi i anëtarit të komitetit për Urbanizëm, i cili tashmë është jashtë vendit që të zëvendësohet me një anëtar të ri.

Argjend Thaçi: Atëherë e hedhim në votim pikën e propozuar nga Vetoni. Kush është që kjo pikë të futet si pikë e rendit të ditës?

Në mënyrë unanime, ky propozim hynë në rend të ditës. Këtë e vendosim si pikë të 9 dhe pika 9 e cila është të ndryshme kalon në pikën 10.

Urdhëro Alban!

Alban Kastrati: Pika e 6- Dhënia në shfrytëzim e pronës së palujtshme në pjesën e ngastrës kadastrale nrP-72310012-00394-0, në vendin e quajtur Gurina-rruga e Raqit në fshatin Vërmicë, sipas materialit që na është sjellë nuk kemi material lidhur me këtë temë sipas infomatave që kemi marrë kjo qështje ka kaluar në gjykatë dhe mirret gjykata me këtë rast, është mirë me e tërheq prej rendit të ditës dhe mos me u marr me këtë qështje sepse ka kaluar te organet tjera kompetente.

Argjend Thaçi: Faleminderit Alban, urdhëro Halil!

Halil Morina: Propozimin që e bëri Albani, unë kam ndëgju që ka një vendim gjyqësor lidhur me këtë qështje dhe kishte qenë mirë që ne me e pa këtë vendim gjyqësor për çka është duke u bërë fjalë dhe qfarë përmbajtje ka ai vendim. Kishte qenë mirë që sot me e tërheq nga rendi i ditës, pastaj me i mbledh këto informacione dhe këto vendime gjyqësore.

Argjend Thaçi: Faleminderit Halil, urdhëro Mirëllinda!

Mirëllinda Gashi: U kërkua që të tërheket kjo pikë nga rendi i ditës, mirëpo unë kisha kërkuar që ky qytetarë është duke e bërë këtë kërkesë që nga viti 2013 ose të i dhurohet e drejta ose të i ndërprehet. Në qoftëse është e rregulluar me ligj, në qoftëse është vepër të cilën nuk mundemi me ja dhënë atë të drejtë me e hapë atë lokal, atëherë është kompetencë e Kryetarit. Me adresu këtë kërkesë kryetarit dhe ai me u marrë me këtë. Unë kërkoj një sqarim nga Muharremi se çka thotë ligji për këto kërkesa.

Argjend Thaçi: Faleminderit Mirëllinda, Urdhëro Nënkryetar!

Vesl Krasniqi: Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës pajtohna që ka vite që kërkon të i lejohet një hapsirë për ndërtimin e një lokali afaristë për ushtrimin e veprimtarisë si mini market. Por në mandatin e kaluar ka ardhur në rend të ditës dhe për arsye që nuk ka pasur vota të mjaftueshme

nuk ka kaluar dhe ka insistuar përsëri. Ne si ekzekutiv jemi të obliguar që kërkesat e qytetarëve me i adresu të cilat konsiderohen si kompetenc e asambles komunale që në këtë rastë është kompetencë e juaja. Kështu që ju konsideroni a dëshironi me ja leju në shfrytëzim apo jo sepse tani më nuk është detyrë e Kryetarit.

Argjend Thaçi: Faleminderit Nënkyetar, urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Kryesues një vërejtje së pari duhesh me ja dhënë një asambleisti fjalën kur ta kërkon pastaj qeverisë. Që ta lejojmë një pronë në shfrytëzim duhet që një vit para me e bë një listë të pronave se a ka komuna interes me dhënë në shfrytëzim. Pastaj zhvillohet një ankand kush ka me qenë shfrytëzuesi i kësaj prone ne duhet me i diskutu këto gjëra. Kisha kërku që procedurat të zbatohen ashtu siq janë me ligj dhe ne të japim vendimin që kjo pronë të dhurohet në shfrytëzim apo jo.

Argjend Thaçi: Urdhëro Arlind Morina!

Arlind Morina: Kërkoj që të futet në rend të ditës zëvendësimi i anëtarit të komitetit për Diasporë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Arlind! E hedhim në votim propozimin e Alban Kastratit për tërheqjen e pikës 6. Dhënia në shfrytëzim e pronës së palujtshme në pjesën e ngastrës kadastrale nrP-72310012-00394-0, në vendin e quajtur Gurina-rruga e Raqit në fshatin Vërmicë. Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 6

Me 18-për, 0-kundër, 6-abstenim largohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kemi propozimin e Arlind Morinës për zëvendësimin e antarit të komitetit për Diasporë. Kush është që kjo pikë të hyjë në rend të ditës?

Në mënyrë unanime hynë kjo pikë në rendin e ditës.

Kush është për miratimin e rendit të ditës me ndryshimet që u bënë ?

Në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

Fillojmë me pikën e parë që është:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit nr.02/211 datë: 05.05.2022 për themelimin e vend gjuetisë, në Komunën e Malishevës. Është një pikë ku ministria ka kërkuar rishqyrtimin e saj, e ardhur nga Drejtoria e Bujqësisë kërkoj nga ana juaj Kryetarë Kastrati që të kërkonin nga asambleja komunale në Malishevë që të shfuqizojë vendimin e themelimit të vend gjuetisë nr. 02/11 datë: 05.05.2022 për arsye se me një vendim të tillë për themelimin e vend gjuetisë të përbashkëta në komunën tonë përfshihen vetëm një e treta (1/3) e sipërfaqeve të përgjithshme të lejuar në territorin e Malishevës që ka vetëm

10.000.000hk. Për të sqaruar më shumë për këtë pikë të rendit të ditës e ftojë Drejtorin e Bujqësisë z.Dukolli.

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë!

Pasi që kërkohet nga MAPL-ja që të shfuqizohet ai vendim ne kemi ardhur me një kërkesë të re e cila është në pëlqim të plotë me vendimin që e ka dhënë për Komunën tonë ministria e Bujqësisë pylltaris dhe zhvillimit rural në vitin 2007 e nënshkruar nga ministri Idriz Rafi. Kërkojmë që të aprovohet kjo kërkesë bazuar nga pëlqimi i ministris së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 10.02.2009 ku përcaktohen dy zona për vend gjueti të përbashkëta për Komunën e Malishevës: Zona 1 dhe Zona 2 bazuar në ligjin për gjueti pikërisht në udhëzimin administrativ MA-NR 10/2007. Me pëlqimin e ministris së Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural nr.280/02 të datës 10.02.2009 figurojnë 30.585.34hk sipërfaqe pyjore në komunën e Malishevës të ashtu quajtur Malisheva1 me sipërfaqe të përgjithshme 16.241.05hk dhe Malisheva2 me sipërfaqe të përgjithshme 14.344.29hk. ne kërkojmë një vendim nga asamblea komunale sa më shpejtë për themelimin e këtyre dy vend-gjuetis në këto dy zona ku do ti përmendim me emra se cilat vende i përfshinë Zona1 dhe Zona2. Vend gjuetia Malisheva1 përfshinë: Berishë, Tërpezë, Iladroc, Senik, Banjë, Ngucat, Temeqinë, Bellanicë, Kravasari, Guriqi, Marali, Magjarrë, Janqistë, Pagarushë, Shkozë, Astrazup. Malisheva2 përfshinë: Dragobil, Burimin, Carravranën, Turjakë, Panorc, Llapqevë, Bubël, Damanek, Lubizhdë, Mirushë, Carrallukë, Drenoc, Bubavec, Kijevë, Mleqan, Plloqicë, Gullubovc, Llazicë dhe Balincë, shkarashnik. Kërkoj nga këshilltarët që të shfuqizojnë vendimin që është dërguar më herët dhe është kthyer me kundërshtim me vendim të ministris dhe të miratohet me votat tuaja vendimi i ri i cili është me pëlqim të plotë me ministrin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të lëshuar në vitin 2009.

Argjend Thaçi: Faleminderit Drejtor për këto sqarime, urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë, qdo vendim që MAPL-ja kthen si jo të ligjshëm ne duhet ta shfuqizojmë. Kështu që ne duhet ta shfuqizojmë këtë vendim dhe ta votojmë vendimin që e sjelli Drejtoria për Bujqësi, për mua nuk është problematike nëse e dhurojmë të gjithë atë pjesë për gjueti.

Argjend Thaçi: Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Gjysma e pyjeve janë private dhe kanë me sjellë probleme në teren. Ne si grup i VV-së rezervohemi në votim të këtij vendimi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor!

Syl Dukolli: Unë e kam lexuar ligjin për gjueti e ceke Veton pjesën private dhe shoqërore, ekziston gjueti e mbyllur e cila bëhet në kushte të cilën e ushtron kush e ka të drejtën dhe liqencën dhe të gjitha gjërat do të cekën në shpallje se cilat gjëra duhen dhe cilat jo. Ekzistojnë dhe gjuetitë e hapura dhe janë forma të gjuetive që ligji po e njihke dhe gjuetinë e mbyllur që

mund të jetë e përkufizuar. Nuk besoj që mund të ketë dëme dhe që mund të i prishet prona dikujt.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nënkyetar!

Vesel Krasniqi: Një plotësim shumë të shkurtër sa i përket anës ligjore e tha dhe Drejtori mjaftueshëm, ministria ka kërkuar që zonat të cilat kanë qenë të përcaktuara nga niveli qëndror për gjueti e konkretisht për Malet e Berishës e cila lidhet me Blinajet dhe janë të përcaktuara si zonë gjuetie. Ka rrjedhë një gabim teknik në vendimin e parë shefi i Drejtorisë më herët e ka sjellë vetëm pjesën në malet e Zatriqit, Gurbardhë dhe këtë pjesën ndërsa nuk e ka përfshi dhe parcelen për të cilën dhe e kanë anulë këtë vendim Ministria. Komuna gjegjësishtë prokurorimi bënë shpalljen publike dhe ato mund të ofortojnë kompani apo biznese të cilat mirren me këtë fushë dhe zgjedhet një kompani. Pastaj ata të cilët në mënyra private e kanë hobi gjuetinë duhet të paisen me leje tek kompania në fjalë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Nënkyetar për këtë sqarim, urdhëro Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi: Mendoj që inspektoriati punon në drejtim që mos t'i lejoj të përdorin armë pa leje, dhe nuk po e shoh të arsyeshme që ne me e kundërshtu këtë. Ne si grupë e mbështesim këtë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Po pajtona me kolegun Veton që tha është mirë që me ja bashkangjitet një dokument se çka lejon ligji e çka jo, që të shohim ne se a është në përputhshmëri me ligjin apo jo. Përndryshe siç tha dhe shefja e grupit ne e mbështesim këtë kërkesë.

Argjend Thaçi: Alban, nuk po besoj që është nevoja që për qdo pikë të rendit të ditës të ju bashkangjitem ligjet që ju përkasin.

Halil Morina: Nuk besoj që është e domosdoshme Alban, sepse po bëhet shumë dokumentacion me i ngarku dhe ligjet cilat janë, në kërkesë i kemi udhëzimet dhe në cilin ligj bazohet kjo kërkesë kemi pasur kohë të mjaftueshme që të hulumtojmë për ligjin.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim pikën e rendit të ditës 1. 1.Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit nr.02/211 datë:05.05.2022 për themelimin e vend gjuetisë në Komunën e Malishevës. Kush është për?

Për- 22

Kundër- 0

Abstenim- 4

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te pika e dytë e radhës e cila është: 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa dhe Buxhet nr.04/724 datë: 01.08.2022. Për ta prezantuar këtë pikë e ftojë Drejtorin për Politik dhe Financa z.Blerim Thaqi.

Blerim Thaqi: Përshëndetje për të gjithë!

Në komitetin për politik dhe financa e kam përcjellur dy herë këtë kërkesë për shuarjen e disa bizneseve që faktikisht janë pasive nuk janë aktive duke filluar nga viti 2021-2022. Është kërkuar nga komiteti që të plotësohen disa përgjigje dhe në takimin e fundit ka qenë dhe Drejtori i inspektoriatit, ne jemi munduar që të japim sqarimet përse është e arsyeshme që të shlyhen obligimet e taksës komunale ndaj këtyre bizneseve që nuk ushtrojnë veprimtarin e tyre. Shuma totale e obligimeve për komunën ka vlerë rreth 119.000.00E, është mirë që të mirret ky vendim që të shlyhen këto obligime nga bizneset komunale jo aktive. Kisha kërkuar që të lirohen këto biznese nga këto obligime që janë pasive që të mos figurojnë në buxhetin e komunës.

Argjend Thaqi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë e kam pasur një takim me përfaqësuesin ligjor të ministrit për këtë qështje dhe nuk doli argumenti të cilin e ka thënë Drejtori i Inspektoriatit në komunën e Malishevës për disa biznese të cilat kanë kërkuar që të pastrohen nga kjo listë. Janë 119.000.00E që po kërkohet me ju falë bizneseve, ajo që kamë kërkuar në KPF- është që kjo listë nga shumë biznese të cilat e kanë deklaruar shuarjen e tyre dhe kanë borxh ndaj Komunës të njëjtat po vazhdojnë me operu në Komunën e Malishevës. Nuk dua të cekim emra, sepse pastaj po personalizohet debati. Ne si VV nuk e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës, sepse nëse po vazhdojmë me i falë borxhet atëherë ne po i inkurajojmë dhe bizneset të cilat janë përgjegjshëm me vazhdu qasjen e njëjtë mos kryerjen e obligimeve ndaj Komunës.

Argjend Thaqi: Urdhëron Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Unë po pajtohna me shumicën e diskutimit të kolegut Veton, që ka biznese që janë aktive. Kisha kërkuar dhe një sqarin nga Drejtori pse nuk janë eliminuar dhe pse po ndodh kjo sepse nëse vazhdojmë e votojmë këtë po i bie që nuk po i konsiderojmë qytetarët të barabartë.

Argjend Thaqi: Urdhëro Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Diskutuan dhe kolegët rreth kësaj qështje, mirëpo këtu nuk kemi të bëjmë me përkrahje të bizneseve, po të kishte lidhje me të vërtet që ti ndihmohej bizneseve edhe unë do ta kisha përkrahur. Jam kundër kësaj për arsye se munden në të ardhmen me vepru në këtë formë dhe shumë biznese të tjera.

Argjend Thaqi: Faleminderit Valon, urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Jo vetëm neve si komunë, por dhe të gjithë komunave të Kosovës në nivel qëndror ju ka shfaqur kjo qështje e borxheve ndaj agjensioneve publike. Kjo është një problematik dhe kjo është një dëshmi që ne ende nuk kemi krijuar një kulturë institucionale, sepse prej që ka ekzistuar shteti si koncept qoftë dhe në format më primitive taksa ka ekzistuar si kulturë e institucionit. Është detyrë e institucionit që me kërkuar atë taksë ose borxh në formë të ndryshme.

Andaj që mos të na mbetet ky borxh ne duhet me e gjetë një mënyrë se si me eliminu këtë. Nëse këto biznese janë me të vërtetë të shuara e jo të manipuluar në emër të shuarjes, atëherë kishte qenë më mirë për ne me shty ose me tërheq këtë borxh. Kishte qenë më mirë të formohet një komision që të mirret jo vetëm me bizneset e shuara por dhe me këtë borxh të keq. Unë kisha kërku sqarime shtes ndaj sponzorizuesve të kësaj kërkesë me pa se a janë të gjitha këto biznese të shuara në mënyrë që ne sot ta falim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Ne si VV jemi pro e këtyre bizneseve të cilat janë të shuara, ajo e cila nuk është aktive e falim si borxh por ne po flasim për bizneset të cilat vetëm e kanë ndërruar emrin atyre nuk kemi asnjë pamje ligjore që të ja falim borxhin.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nënkyetar!

Vesel Krasniqi: Ne kemi sjellë para jush një raport për gjendje të bizneseve që sipas inspektoriatit së bashku me zyrën për regjistrimin e bizneseve në komunën e Malishevës, kanë konstatu bizneset të cilat janë në listë nuk i kanë përfunduar obligimet e tyre për kohën sa kanë qenë. Unë ju kisha ftuar që mos të shtyhet por të marrin përgjegjësi përfundimtare për këtë qështje është mirë që me secili përfaqësues të grupeve të bëjmë një takim në zyre të biznesit ose të inspektoriatit dhe për secilin të debatohet dhe ato që janë me u shu të shpallen pasive me ndjek këtë rrugë që mos të shtyhet dhe një herë. Rasti tjetër u përmend që X biznesi i bënë ndryshimet, secili qytetarë mundet me regjistru biznesin dhe me ndryshu te zyra e biznesit në Komunë por dhe në Ministri të Tregtis dhe Industrisë, dhe disa biznese në fjalë ARPK-ja nuk ja kërkon vërtetimin se a i ka paguar taksat apo jo pra ja pranon dokumentat si të rregullta. Është mirë që ta definojmë këtë qështje dhe ti selektojmë ato të cilat ju mendoni me i shpall pasive, dhe ato që duhet të i kryjnë obligimet.

Argjend Thaçi: Nënkyetar po besoj që si asambleistë nuk mundemi me e bërë asnjë biznes aktiv as pasiv është sistemi i cili i vendos pasiv apo aktiv. Urdhëro Drejtori i inspektoriatit dëshiron me dhënë një sqarim!

Hafir Rexha: Përshëndetje për të gjithë!

Pajtohem me një pjesë të diskutimeve të kolegëve që figurojnë biznese që operojnë nga i njëjti individ, por jo me letra dhe jo me të njëjtën firmë. Ne si inspektoriat kemi shkuar te zyra e bizneseve dhe sistemi e deklaroi se është i shuar, ne si inspektoriat nuk mundemi me e marrë asnjë vendim ligjor sepse ai ka arritë në sistem. Kjo që e tha nënkryetari pajtohem dhe me propozimin e tij, ky është si një lloj vëzhgimi sepse nuk besoj që një zyrtarë mundet biznesin atktiv të shëndrroj në pasiv. Është e vërtetë Veton që një person e ka pas një firmë dhe mbas 3 ose 4 vite e ka ndryshuar, por nuk jemi ne fajtor është sistemi, kjo qështje duhet të rregullohet kur kuvendi komunal e bënë rregulloren për ngarkesa dhe tarifa.

Argjend Thaçi: Urdhëro Labinot!

Labinot Gashi: Unë besoj që kjo gjendje që ka ardhë, është ardhë nga hapat e gabuar dhe shuarja e biznesit e ka procedurën e vetë. Të paktën nuk është dashur të pranohet një gjë e tillë që me ja shu borxhin. Në këtë listë po figurojnë biznese që janë shuar dhe në vitin 2021, dhe ka biznese që janë shuar në vitin 2009 nuk është e drejt me ja kërku borxhin një biznesi që është shuar në vitin 2009 dhe biznesit që është shuar ndoshta as 2 muaj nuk i ka me ja falë. Unë propozoj që me bërë një premje kohore, ato që i kanë tejkaluar afatet të cilat komuna nuk ka të drejtë borxh me ju kërku me i tërhek, ndërsa të tjerat me vazhdu me ja kërku borxhin.

Vesel Krasniqi: Komuna niveli lokal nuk mundet me parandalu as ndryshimin në biznes as shuarjen e biznesit sepse ARPK-ja e kërkon vetëm vërtetimin a i ke përfunduar obligimet ndaj shtetit pra vërtetimin në ATK, ju është servuar si e drejtë niveleve lokale se a dëshiron me vendos taksa vjetore, fikse që vendosen përmes asambles dhe në këtë rast ata e kanë shfrytëzuar në nivel qëndror i kanë bërë ndryshimet. Është e drejtë e juaja se a dëshironi me i shly këto obligime e vetmja e keqe këtu është që na shkakton problem në saktësi të inkasimit të të hyrave pastaj dhe në realizimin e burimeve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi: Këto biznese nuk janë të shuara janë pasive sepse nëse shuhet nuk kemi nevojë me i liru prej obligimeve. Drejtorja e financave ju ka drejtuar juve si organ i cili ju jeni ata që mund ti lironi nga obligimet bizneset mbi bazen e raporteve që i ka dhënë inspektoriati ne nuk kemi ditë cilat biznese janë aktive dhe cilat pasive, kemi kërkuar nga ata që të na sjellin një raport. Kërkesa jonë është ose të i lirojmë ose të gjejmë një formë të inkasimit të tyre.

Argjend Thaçi: Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Meqë ne nuk kemi asnjë alternativ në momentin që figuron në ARPK që një biznes është pasiv ne duhet ta marrim pasiv, sepse nuk kemi alternativ tjetër dhe nëse e dim që ai ka bërë manipulime të ndryshme. Nëse një biznes është pasiv nëse ne nuk kemi të drejtë me ja kërku borxhin një biznesi pasiv ne nuk kemi rrugë të tjera vetëm ta shlyejm atë borxh.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Përshëndetje dhe një herë të gjithë!

Rendi i ditës thotë me i falë borxhet e bizneseve, sepse janë të shuara, për secilin biznes shënon data e shuarjes. Nuk kishte asnjë biznes që nuk e ka datën e shuarjes, nuk janë biznese pasive por janë të shuara totalisht. Ka biznese që janë pasive, një biznes pasiv nuk e ushtron aktivitetin e saj afaristë, por në letra figuron ende si biznes ndërsa bizneset e shuara nuk ekzistojnë. Sa i përket kërkesave ndaj borxhit në secilin vit sa herë që ka pasur ngarkesa, biznesit ju është dërguar aktvendimi për krijimin e detyrimit ndaj komunës në nivelin lokal. Sa kam qenë unë Drejtor nuk e kemi kërkuar borxhin mbrenda ati viti ka qenë gabim por dhe në të kaluarën nuk ju është kërkuar borxhi, ligji i mardhënjeve dhe detyrimeve thotë që këto borxhe kanë të drejtë të kërkoen deri në tri vite në aspektin e vjetërsisë së tyre. Qëllimi është këtu sa po mundemi me i

pastru ne këto lista të llogarive të arketueshme, nëse pastrohen këto normal që kan ndiku dhe në rritjen e performancës së Komunës. Pyetja ime është: Qka ndodh me bizneset pasive të cilat e kanë regjistruar biznesin në vitin 2010 të cilat nuk e kanë ushtruar aktivitetin e tyre asnjë herë mirëpo që ato figurojnë si biznese që janë në listën e ARPK-së konkretisht në zyren komunale të biznesit. Unë kisha kërku borgjet që janë ndaj komunës të pastrohen më tepër se sa është kërkesa e drejtoris së Financave, dhe propozimi im është që deri sa na lejon dhe ligji i mardhënjes dhe detyrimit komuna të merr vendim përmes ekzekutivit kisha kërku që deri në tri vitet e fundit të falen të gjitha borxhet, të pastrohen të gjitha llogaritë e arkëtushme, kur ndodh kjo me secilin prej obliguesve ndaj komunës të krijohet një marrveshje që borxhi falet nëse i paguan borxhet për këto tri vitet e fundit. Pjesa tjetër të ketë kriteret dhe të zbatohen kriteret, përveq aktvendimit të ju dërgohen njoftimet me kohë për arkëtim të borxhit.

Argjend Thaçi: Urdhëro Nënkrjetar!

Vesel Krasniqi: Për bizneset të cilat janë aktive që nuk i kanë përfundu obligimet si taks komunale ndaj komunës për herë të parë është inicuar procedur gjyqësore, raportin 9 mujor të cilin do ta keni shumë shpejtë te pasqyrat financiare do ta vëreni inkasimin e të hyrave vetanake për bizneset që janë ngarku me taks komunale që është shënuar një rritje. E ceki valoni se qka është bërë me bizneset pasive dhe si janë verifiku? Bizneset pasive janë mbajtur nga inspektoriati procesverbal, secili biznes që regjistrohet e paraqet selin e vet, dhe inspektoriati ka konstatu që bizneset në fjalë nuk ushtron në komunën e malishevës por është pasiv.

Argjend Thaçi: Urdhëro Halil!

Halil Morina: Seancën tjetër e kemi afër është mirë që ta shtyjme këtë pikë me i dikutu të gjitha këto problematika që janë. Unë propozoj që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Argjend Thaçi: I ftojë shefat e grupeve ose nga një përfaqësues nga secili subjekt politikë që mbas seancës të bisedojmë dhe të caktojmë një takim së bashku me zyrën e biznesit dhe inspektoriatin. E hedhim në votim që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës: 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Financa dhe Buxhet nr.04/724 datë: 01.08.2022. Kush është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet?

Me vota unanime, konsideroj që kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancën e radhës.

23 anëtar të kuvendit janë prezent aktualisht, që do të thotë kemi korum të vazhdojmë punimet. Pika e radhës është pika e: 3.Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, për përgaditjet dimërore nëpër shkolla.

Ftojë Drejtoreshen e Arsimit që ta prezantojë këtë pikë të rendit të ditës.

Arbëresha Krasniqi: Përsëndetje për të gjithë.

Ne kemi filluar përgaditjet dimërore në shkolla. Ju e keni para vetës një raport nga Drejtoria për Arsim në të cilin jemi munduar që në pika të shkurtëra të e cekim gjendjen tonë në shkolla. Në të gjitha shkollat kemi bërë përgaditjet ideale që të fillojë sezona e dimrit, ne të gjithë e dimë që është data 15 nëntor, ku duhet të jemi të përgaditur me nxemje në shkolla, kemi nënshkru disa kontrata dhe përgaditja dimërore nuk do të thotë që i bie vetëm nxemjet qëndrore por nënkuton gjithë përgaditjet në sistemin arsimor në

komunën e Malishevës. Jo vetëm në komunën tonë por në gjithë komunat e Kosovës kemi dhe parashihen probleme efikente, në institucionet publike e në këtë rast në shkollat tona. Në kuadër të përgaditjes së këti gjysëm vjetori që ka filluar me vones si rezultat i grevave në Kosovë, dhe muaji tetor është muaji i fillimit të ri i vitit akademik ne jemi ballafaquar me shumë situata, dhe një prej tyre ka qenë situata e konkurseve në Komunën e Malishevës ku kemi realizu pothuajse dhjetra konkurse të cilat kanë përfunduar pa pasur ndonjë proces të ankesave. Jemi munduar që ta ngrisim cilësinë në arsim, duke marrë në arsim dhe duke rekrutuar mësime në cilët plotësojnë kriteret dhe janë të përgaditur për me qenë mësime. Në kuadër të kësaj ne kemi konkursin dhe për Drejtorë në disa shkolla, konkursi tashmë zyrtarisht është i përfunduar dhe ne në seancën e kaluar e kemi marrë votimin nga asamblea për komisionin i cili do ta trajtojë këtë konkurs. Uroj që do të përfundojnë sa më shpejtë dhe të fillojnë dhe me rekrutimin për Drejtor, me të cilët unë mendoj shumë që ne do të hapim rrugë bashkërisht në drejtim të përmisimit, dhe kushteve më të mira në shkolla po ashtu cilësisë në arsim.

Në kuadër të komunës ne si DKA i kemi nënshkruar disa kontrata duke filluar nga paisja me mjete higjienike që të mbahen shkollat sa më pastër dhe po ashtu kemi institucionet tona të cilat me marrëveshje janë në shërbim që nënkupton një pastrim gjeneral të institucioneve që përfshinë dy shkollat e mesme, dy qerdhet, qerdhen aktuale dhe atë të cilën pritet të hapet sa më shpejtë. Një nga informacionet tona pozitive mendoj që më pozitivisht do ta presin të gjithë mësime të cilët punojnë qoftë si bashkëshort apo si prind, ata do të kenë mundësi që fëmijet e tyre të i rahatojnë në institucionin e ri shkollor që do të jetë në kuadër të “Zërat e ëmbël” në Malishevë të cilën jemi në përgaditjen finale që të hapet dhe kapaciteti i tyre është 60-80 fëmijë.

Paisja me dru unë kam kontakt me të gjithë Drejtorët e shkollave është duke u bërë një përmisim i duhër dhe një metrazh e saktë e druve, secili drejtor që ka pranë metren e Druve ka pasur të raportoj qoftë për cilësinë e druve qoftë dhe metrat e druve. Kemi mungesë për pelet dhe për dru por ne jemi duke u bërë të pamundurën që shkollat të i paisim në mënyrë të duhur që këtë dimër të mos kenë vështirësi. Vendimi që është marrë nga MASHT-i që të përdoren lëndët djegëse dhe thëngjilli është vendimi i cili ka qenë është kthyer për arsye të mungesës së efikacës në Kosovë.

Renovimi i shkollave është njëri nga projektet ku pothuajse të gjitha shkollat kanë pasur nevojë që të rregullohen nga pak, por në fokus të veçantë të disa nga institucionet tona. Këto institucione ndër vite janë dëmtuar qoftë nga reshjet atmosferike, apo nga vetë dëmtimi që është bërë nga vetë nxënësit dhe nga rezultati i viteve që janë shfrytëzuar dhe objektet po e presin me padurim renovimet që do të bëhen në shkolla. Kompania e cila po e bënë renovimin secili nga mësime të cilët po ndihen mirë për renovimet që po bëhen. Për fund pasi që jemi në muajin tetor që është muaj për solidaritetin me kancerin e gjirit ju kisha bërë thirrje të gjitha grave të komunës së Malishevës që shërbimin ta përfundojnë në shtëpinë e shëndetit në Malishevë, pasi që ne e kemi në shërbim mamografinë dhe të trajtohet me kohë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Drejtoreshë, urdhëro Gentianë Hoti!

Gentianë Hoti: Përshëndetje për të gjithë!

Unë e kam lexuar Raportin e DKA-së dhe e përgëzoj për punën dhe angazhimin tënd, dhe të stafit të DKA-së. Kërkesa juaj për plotësimin ose rritjen e stafit në Drejtorinë e Arsimit është shumë e arsyeshme, sepse Drejtoria e Arsimit kërkon një trajtim më të veçantë. Në raport e shikova që janë bërë pothuajse të gjitha përgaditjet e dimrit, uroj që mos të na përsëriten problemet si i kemi pasur në vitin e kaluar në mungesë të ngrohjes, sepse siç dihet dhe ngritja e qimeve na ka shkaktuar probleme në të gjitha sektoret. Gjithashtu kërkesa tjetër për kordinatorët e cilësisë në shkolla dhe kjo është një kërkesë e qëlluar, sepse kjo na ndihmon shumë në ngritjen e cilësisë në arsim, gjithashtu rritja e psikologëve dhe pedagogëve në

shkolla është shumë e nevojshme. Kontratat që ikeni realizu me paisje, me mjete higjienike dhe shërbim kontratën për furnizim me mjete sportive që në shkollat tona na kanë munguar tash e tri vite. Mandej kërkesa juaj për rritjen e numrit fizik për qerdhe me më shumë se 22 edukatore është shembulli më i mirë në arsim. Dhe hapja e qerdhes së re në Malishev dhe në Kijevë është përkushtimi i juaj për punën. Shfrytëzoj rastin të ju uroj shumë suksese vitin e ri shkollor 2022-2023 nxënësve dhe mësimdhënësve.

Argjend Thaçi: Faleminderit Gentianë, urdhëro Mirë Linda Gashi!

Mirë Linda Gashi: Faleminderit për raportin Drejtoreshë!

Në aspektin e burimeve njerëzore e keni cekë që keni pothuajse staf të kompletuar dhe këtu kërkon 4 punëtor shtes, unë këtë e përkrahi sepse me të vërtetë DKA ka punë dhe në qoftëse shtohet numri i puntorëve në DKA unë e di që do të dalin në teren dhe do të qëndrojnë shumë më afër gjërave që janë duke ndodhur në shkolla.

DKA-ja ka shpallur konkurs për plotësimin e 30 pozitave të punës, a është fjala për mësimdhënës apo drejtorë?

Dhe ma sqaro te edukatorët nxënësit duhet të jenë një paralele 12 nxënës, kërkoj përgjigje dhe në këtë? Sa herë në vit mbani takime me këshillin e prindërve?

Te shkolla "Lasgush Poradeci" në Kijevë janë shtuar profile të reja, sa janë kompletuar ato kabinete apo a keni bërë një marrëveshje që nxënësit të dalin në teren që të përfundojnë praktiken e tyre në shtëpinë e shëndetit apo ku do qoftë që ju i adresoni.

Pastaj ju keni kërkuar që të shtohen psikologë dhe pedagog është e mirëseardhur kjo, është mirë që shkollat të i plotësojnë këto kushte.

Te infrastruktura i pash disa kontrata ndërsa këtu shenon që janë në përfundim, besoj që deri në fund të vitit përfundojnë këto kontrata për infrastruktur mbrenda shkollës dhe dëshiroj të di se gjatë pushimit pranveror sa shkolla janë rregulluar që kanë pasur prishje, sepse kamë ndëgjuar që në disa shkolla është duke u punuar tani me nxemje dhe po pengohet procesi mësimor. Unë e di që në shkolla janë shpërnda lëndët djegëse, mirëpo sipas raportit nuk e plotësojnë as dy muaj. Keni kujdes në këto që mos të kemi vështirësi gjatë dimrit.

Pastaj higjiena, sa më shumë mjete higjienike të dërgohet në shkolla, sepse kanë nevojë. Pastaj ngjyra, letër të ju dërgohet shkollave jo me e detyru prindin me e ble letrën, sepse ka ndodhur kjo.

Në raport po shenon me ju ndihmu disa familjeve që nuk kanë kushte, është e mirëseardhur kjo sepse duhet me ju ndihmu.

Mundësisht të ju vendosen shkollave disa perde që të ju pengohet dielli nëse nuk mundeni të gjitha klasave të paktën këtyre që janë parafillorë deri në klasën e katërt.

Një qështje tjetër desha ta ngris një dukuri e cila po ndodhë te Qendra Kompetencës, nxënësit janë regjistruar në bazë të konkursit që është hapur, tani është java e tretë nxënësit janë vendosur në ditar dhe nxënësi kërkon tërheqjen e dokumentave që të shkojë në gjimnaz. E nderuar Drejtoresh a lejohet që mbasi të fillojë procesi mësimor nxënësit të bëjnë këtë lëvizje? Nxënësit pa problem po pranohen në gjimnaz.

Argjend Thaçi: Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përsëritje për të gjithë!

Po flasim për disa qështje të rëndësishme ajo që e karakterizon këtë vit shkollor është fillimi i vitit me vonesë, unë e kuptoj që ligji për greva i cakton kriteret të cilat duhet të i zbatojnë dhe DKA-ja dhe të gjithë, konsideroj që nuk janë zbatuar të gjitha kriteret nuk mundem me e arsyetu sjelljen e disa drejtorëve

të shkollave që kanë qenë presindikalist në rastin konkret. Pra kam parë thirrje publike me revoltu proceset mësimore dhe po të njëjtit kanë vazhduar mos me qenë në vendin e punës, ky fenomen duhet me u monitoru nga ju Drejtoreshë dhe mos të përsëritet më. Unë

e di që ekziston një kalendar i ri nga MASHT-i për kompenzimin e orëve të humbura nuk e di a është përfill nga ana e juaj si Drejtori. Në sa shkolla është zbatu ky kalendar, nëse jo përse nuk është zbatu ky kalendar i MASHT-it?

Po ashtu si vërejtje e imja qëndron te rekrutimi i stafit të mësimdhënësve, nuk e di sa ka qenë numri i aplikantëve në konkursin e rregullt dhe a ka pasur ankesa në përzgjedhjen e këtyre që janë përzgjedhur? Qështja tjetër është në konkursin e drejtorëve, uroj që ke me i monitoru si drejtori dhe ki me zbatu ligjin në përpikshmëri ligjin për arsimin parauniversitar dhe nuk ke me leju me shku si herën e kaluar konkursi për përzgjedhjen e drejtorëve.

Një fenomen tjetër është renovimi i shkollave që po bëhet duke filluar procesi mësimor, e kem rastin e shkollës “Imer Krasniqi”, “Bajram Curri” dhe prap ka probleme në shkolla, në shkollën “Lasgush Poradeci” nuk punon ndriqimi publik aty mbahet mësimi në dy ndërrime. Të evitohen këto probleme të paktën në shkollat ku mësimi bëhet në dy ndërrime.

Një problem tjetër, furnizimi i bibliotekave shkollore me libra adekuat, në lektyrat adekuate, që ju hynë në funksion nxënësve dhe jo me vazhdu kjo që secili mësues po shenon një libër dhe secili po e dhuron si donacion në shkollë. Nuk po dua të gjykoj sepse dhe ato kanë vlera por ta vendosim një listë konkrete qka të dërgojmë në shkollë.

Problem tjetër është dhe fillimi i kontrollave në shkolla, kontrollat stomatologjike kryesisht nuk kam parë që i keni bërë gjatë këti viti i cili gati dhe përfundoj ky vit. Është mirë që me i bërë këto kontrollat sistematike sepse mundemi me identifiku shumë sëmundje të padukshme te nxënësit. Dua të di sa Drejtoresha të shkollave kemi, sa aplikante kemi në konkursin e fundit dhe ndoshta është mirë pa i hy në hak askujtë ju si Drejtoresh me i shty përpara disa prej tyre të cilat i plotësojnë kriteret akademike dhe profesionale. A ka mësimdhënës që konsiderohen si tepriçë teknologjike dhe sa është numri i tyre?

A keni mundur në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit me i shti në programin që e ka parapa ministria për mësimdhënësit?

A kem mësimdhënës me sëmundje kronike që detyroheni me i shti në pension të parakohshëm? Kur po bëhet e funksionalizuar qerdhja në Kijevë?

Argjend Thaçi: Mendoj që jemi zgjeruar pak tek kjo pikë e rendit të ditës për faktin që si pikë e rendit të ditës është Raport nga DKA për përgaditjet dimërore. Kjo është e rëndësishme por të gjitha këto duhet të diskutohen jashtë rendit të ditës.

Urdhëro Rukije Bytyqi!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

E përgëzoj Drejtoreshën për këtë raport për përgaditjet dimërore që i ka bërë në shkolla. Kam qenë në disa shkolla dhe kam parë që përmisimi është i mjaftueshëm për këtë dimër, gjithashtu diqka që mua po më pengon shumë është që kodi i veshjes sidomos në gjimnaz është në gjendje katastrofale, nuk po e dimë a janë nxënës apo jo. Një tjetër kërkes nga Drejtoresha u cek këtu qështja e punësimit, kërkoj që në konkurset të cilat i keni për puntor teknik të punësohen më shumë femra, besoj që higjiena në shkoll do të përmisohej më shumë. Dua ti ftoj të gjitha grat ta shfrytëzojnë këtë muaj që të kontrollohen ta ken shëndetin në rend të par, para gjitha gjërave.

Argjend Thaçi: Faleminderit Rukije, urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Drejtoresh faleminderit për raportin dhe për laburimin e këtij raporti të cilin e bërë para nesh. Dua të ju uroj nxënësve dhe mësimitdhënësve fillimin e ri të vitit shkollor 2022-2023, i cili ka filluar me vonesë për shkak të grevës. Dhe jo vetëm që ka filluar me vonesë, por për mësimitdhënësit ky vit ka fillu duke qenë të demoralizuar, për arsye të fyerjeve që kanë ndodh duke filluar nga niveli më i lartë deri tek niveli më i ulët. Por për kundër këtyre fyerjeve që i kanë bërë mësimitdhënësit të cilët bëjnë një punë shumë fantastike që ska parë që e paguan punën e tyre. Unë i inkurajoj mësimitdhënësit që të punojnë me fëmijët ashtu siç keni punuar gjithë dhe të mos demoralizohen nga fyerjet e njerëzve të tillë.

Raporti është përgaditur për përgaditjet dimërore që janë bërë në shkollat e komunës sonë. Ky raport bazohet dhe në dy këshilla të tjera që ka të bëjë me burimet njerëzore dhe infrastrukturën shkollore. Sa i përket infrastrukturës shkollore jemi me fat që ne në tri mandatet e kaluara qeveria komunale është marrë shumë me ndërtimin e shkollave dhe krijimin e hapsirave të përshtatshme që me u mbajtë mësimi në kushte optimale. Sa i përket burimeve njerëzore drejtoreshë secili nga ne pajtohet këtu që Drejtoria e Arsimit të ketë staf më shumë, të paktën për secilin nivel të shkollimit të ketë nga një zyrtar adekuat që nga parafillor, fillor të ulët, fillorë të mesëm, në shkollat e mesme, atëherë kur secilit prej këtyre ju bëhet nga një zyrtar besoj që atëherë ka me fillu me ndyshu arsimi. Kur jemi te përgaditjet dimërore kemi paralajmërimet të qeveris për një dimër të ashpër në këtë vit, jo për arsye të temperaturave të ulta por mos siguria e energjis së mjaftueshme gjatë dimrit.

Drejtoresh meqë paralajmërohet një krizë e madhe energjetike gjatë dimrit, sa ka me ndiku mungesa e energjis elektrike në ngrohjen, a ka ndonjë lidhshmëri në mes energjis elektrike dhe atyre kalldajave ngrohëse në shkollë? A duhet me u përpjek me gjet gjenerator, qka ka me ndodh me ato shkollë të cilat janë me dy ndërrime siç janë shkollat e mesme?

Çka ka me ndodh me ndërrimin e dytë nëse nuk kemi me pasur energji elektrike?

Argjend Thaçi: Udhëro Amrush Helshani!

Amrush Helshani: E nderuar Drejtoreshë e Arsimit ju përgëzoj për raportin e detajuar, më vjen mirë që problemet me ngrohje janë evituar. Nxënësit dhe mësimitdhënësit me të vërtetë kanë nevojë për kushte më të mira për të zhvilluar procesin e mësimit. Furnizimi me dru, sigurimi i transportit të nxënësve dhe furnizimi me mjete teknike janë të këti angazhimi të mirë i juaj dhe i stafit të Arsimit, uroj që të vazhdojë ky menaxhim i mirë në mënyrë që të kemi sa më shumë rezultate të larta në fushën e arsimit. Pajtohem dhe me kërkesën e koleges që kodi i veshjes në shkollë të respektohet nga mësimitdhënësit si dhe paisja e nxënësve me uniforma do të ngriste dhe më shumë imazhin e shkollave, sidomos të shkollave të mesme.

Argjend Thaçi: Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Halili është vetë mësimitdhënës dhe pasi që është mësimitdhënës duhet me qenë më konkret në atë që e thotë, nuk e di se cila qeveri ka bërë më shumë se qeveria e tanishme që ka bërë qoftë për ligjin për paga, qoftë me burimet e shpenzimeve për mësimitdhënësit me problemet, pastaj për mësimitdhënësit që janë tepër teknike dhe qëshqipte të tjera këto janë të dukshme. Tani i

ke pas Drejtorët e shkollave kryesindikalist, kur ka bërë njoftim publik drejtoresha Arbëreshë që shkollat janë të gatshme në Komunën e Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Faleminderit Drejtoreshë për raportin!

Meqenëse raporti na ka ardhë si pikë e rendit të ditës që është i specifikum për përgaditjet dimërore ku i ke cek të gjitha në pika të shkurtëra. Në gusht e kemi paraparë një plan të punës nga DKA me rekrutim të stafit, me numër të regjistruar, me numër të paraleleve. Shpresoj që me lëndë djegëse me rekrutim të stafit të bëhet më e mira e mundshme, është mirë që konkursi për drejtorë që të mos vonohet.

Te qështja e konkursit sa është numri i puntorëve të ri që kan nënshkruar kontrat, cili është roli i tyre dhe një pyetje të cilën e bëri parafolsi deri ku kan shkuar procedurat për funksionalizimin e qerdhes në Kijevë?

Argjend Thaqi: Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Në lidhje me kohën kur NISMA ka pasur qeverisjen e arsimit, atëherë unë kam qenë udhëtari më i madh i grevës, dhe i kam thënë që kërkesat janë shumë legjitime dhe greva duhet me vazhdu, sepse unë nuk jamë rob i politikës. Sa i përket se a i ka fyre apo jo mësimdhënësit për këtë në momentin që ti e fynë sindikaten na ke fyen të gjithë neve, sepse dhe ne jemi pjesë e sindikatës dhe në e kemi marrë atë vendim së bashku. Kurr ska qenë greva më e rëndësishme sesa tash dhe kurr nuk është fyer mësimdhënësi më shumë se tash. Nuk mundet me këtë pag që është askush me mbaj punën me këtë inflacion që është, dhe nëse vazhdon kështu nuk ke me pas kujt me ja dhën rrogën dhe nuk ka me punu askush në administratë me këtë rrogë kaq të ulët që është.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Drejtoreshë faleminderit për raportin i cili ka qenë me theks të veçant për përgaditjet dimërore. Deshta me i tregu kolegut që politikat arsimore për mbështetjen e mësimdhënësve të cilët kanë probleme shëndetësore nuk kanë fillu me pushtetin e VV. Drejtoreshë po të kërkoj me e sjellë qarkoren buxhetore që ka ardhur në muajin Qershor ose Maj dhe aty shenon në politikat e reja, politikat ekzistuese për secilin nënprogram të arsimit dhe kjo politikë është futë në buxhet të vitit 2020 për buxhetin e vitit 2021. Mundesh me pa saktë kërkoje qarkoren buxhetore dhe e sheh që kjo është një politik në vazhdimësi dhe këtë pa dashur me ja mohu dikujt ka qenë në qeveri LDK, ka qenë propozim i LDK që këto me u fut në qarkoren buxhetore.

Argjend Thaqi: Urdhëro Veton Zogaj replik.

Veton Zogaj: Unë jam këtu me repliku për secilën pikë të rendit të ditës ku nuk e kanë bërë punën siç duhet kur ki një varg problemesh që lidhen direkt me Drejtorin e Arsimit. Unë kam

punuar me mësimdhënës të cilët kanë pasur probleme me kancer dhe deri kur ka vdek a detyru me qenë në vend të punës.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Politikat arsimore për sëmundje shëndetsore për mësimdhënësit me dal në pension të parakohshëm është e vitit 2020 është e buxhetuar për vitin 2021. Nuk është e VV unë ta sjelli qarkoren buxhetore.

Argjend Thaçi: Urdhëro Donjetë Shijaku!

Donjetë Shijaku: Përshëndetje për të gjithë!

Drejtoreshë të përgëzoj për raportin por kishe bërë mirë me ardhë në fshatin Temeqinë dhe me shiku klasën parafillore se ku mbajnë mësim fëmijët. Me një klas të mbushur me myk, me një stuf që e mbush klasën tym e cila është shumë rrezik për shëndetin e fëmieve. Kisha pas dëshir që të mirren masa sepse ka vite që është e pa rregulluar.

Argjend Thaçi: Urdhëro Drejtoreshë për përgjigjien e pyetjeve.

Arbëresha Krasniqi: Personalisht ju përgëzoj të gjithëve për kontributin dhe për angazhimin që bëtë në kuadër të kësaj pike. Arsimi është më i rëndësishmi në shoqërinë tonë, dhe i gjithë diskutimi i juaj është që ti kontiboj procesit arsimor në komunën e Malishevës.

Genta të faleminderoj për gjithë elaburimin që e bërë ndoshta dhe më të hollësishëm se vetë raporti i Drejtoris së arsimit dhe unë ju ftoj duke fillu nga Genta që ishte e para në diskutim e deri te Donjeta që të gjithë së bashku të bëhemi dhe të i shtyjme së bashku të gjitha proceset arsimore në komunën e Malishevës.

Mirëlinda e ceku nga perdet dhe deri te psikologët dhe pedagogët në shkolla, të gjitha janë këto tema që unë çdo ditë i trajtoj dhe mundohem me ju dhënë zgjidhje. Një nga rastet të cilën e kemi bërë për her të parë është në komunën e Malishevës me një konkurs që kemi kërku me ngulm nga Ministria e Arsimit ka qenë 3 mësimdhënës të cilët trajtojnë fëmiet me nevoja të veqanta dhe si rezultim ka ndodhë. Ne kemi bërë përgaditjet dimërore sa i përket nxemjes së shkollave dhe për këtë arsye kemi sjellur planin para jush. Këshilli i prindërve ne takohemi me këshillin e prindërve, shef i Drejtoris së Arsimit është Sabit Berisha të cilin e kamë delegu që të mbajë takime me këshillin e prindërve dhe për secilën situat dhe vendim që marrim ne, ne kemi konsulta me këshillin e prindërve.

Sa i përket tërheqjes së dokumentave të nxënësve nga shkolla Qendra e Kompetencës unë nuk e kamë këtë informacion. Për herë të parë Qendra e Kompetencës dhe shkolla IAAP në Kijevë ka pasur rritje të numrit të nxënësve që ka pasur ndonjëher, sepse në Gjimnaz kemi vendos kriter. Të gjithë fëmiet të cilët kanë shkuar në drejtim të Gjimnazit është dashur të i plotësojnë dy kriterë, kriteri i parë ka qenë të jenë nxënës të shkëlqyeshëm, kriteri i dytë nëse nuk është plotësuar numri me nxënës të shkëlqyeshëm janë pranuar nxënës me sukses të shumë mirë. Qka ka ndodhë tash nuk kam informacion por do të merrem me këtë qështje. Kriteri bazë i nxënësve që pranohen në drejtimin e ri të infërmjesisë që nënkupton numrin 24, ka qenë që të jenë nxënës

të shkëlqyeshëm.

Perdet në shkolla ne e kemi futur si kërkesë në buxhetin për vitin 2023 dhe besoj që në gjitha ato objekte që ne kemi frekuentim të diellit në drejtim të klasave do të i paisim me perde.

Donjetë ajo qështje që e ngrite është e vërtetë që në shkollën në Temeqinë kemi disa probleme me mykun, kjo ka ardhur si rezultat i reshjeve të fundit atmosferike që e ka ndërlikuar dhe më tutje problemin, jo vetëm në një klasë por në disa klasa të asaj shkolle. Unë thash që jemi në renovim, renovimi nënkupton edhe lëvizjen dhe evitimin e atyre problemeve që i kemi me lagështinë dhe problemet tjera. Jemi duke e shfrytëzuar kontratën të cilën e kemi në fuqizim. Të faleminderoj për ngritjen e shqetësimit tënd.

Shkolla e mesme në Kijevë e ceki Vetoni ndriqimi në shkolla, furnizimi me libra, sa mësimdhënës janë tepër teknologjike, qerdhja në Kijevë dhe disa qështje të tjera. Në takimet që i kemi bërë me ministrin e arsimit tema që më së shumti është diskutuar është teknologjia e gabuar të teprit teknologjike. Nuk ka faj asnjë mësimdhënës që ka rënë numri nxënësve dhe numri i normave, nuk mundësh me e quajtur tepër teknologjike Linden dhe Halilin këta janë mësimdhënës të rregullt të cilët e kanë përfunduar fakultetin dhe e kanë marrë një kualifikim nga personat të cilët janë të përgaditur shkencërisht. Këta janë me mungesë të fëmijëve ose të normave në institucionet ku kanë dhënë kontributin, dhe si rezultat që nuk kanë tepër teknologjike ministria e arsimit nuk ka guxuar me bërë politika përjashtuese të këtyre puntorëve. Janë 137 mësimdhënës që janë më tepër në komunën e Malishevës. Unë para jush i falenderoj të gjithë mësimdhënësit e komunës së Malishevës të cilët kanë tregu gaditshmëri dhe një profesionalizëm dhe që kanë gjetur mirëkuptim në të gjitha shkollat të gjithë ata mësimdhënës të cilët janë prek me fondin e orëve. Nuk është e lehtë ku secili mësimdhënës minimalisht është prek në dy ose katër orë më pak në shkollat tona. Strategjia e jona si DKA ka qenë që të mos i shpallim konkurset ose të i shpallim në minimum duke e pasur parasysh numrin e vdekur të mësimdhënësve që e kemi në Malishevë. Dhe kur kemi pasur pensionim të mësimdhënësve në shkolla nuk kemi hapur konkurs duke pasur parasysh numrin e ulët të orëve.

Qerdhja në Kijevë është e finalizuar është bërë pranimi teknik, ne me insistimin tonë të përfunduar në drejtim të kësaj qështje kërkesa jonë ka shkuar në komisionin për buxhet dhe financa në kuadër të kuvendit të Republikës së Kosovës, e njëjta kërkesë me na leju numrin e ri fizik të puntorëve ka shkuar në Ministrinë e Arsimit. Si rezultat i presionit që i kemi bërë ne si komunë e Malishevës, ata na kanë leju në qarkoren e re buxhetore 22 numra të ri fizik krahasuar me kërkesën që e kemi bërë afër 44. Por meqë ka ndodhë kjo ne prap do të funksionojmë, së shpejti do të shpallet konkursi për edukatorët për qerdhe dhe ne do të i paisim me fëmijë.

Kodi i veshjes e ceku profesoresha Rukie dhe njëkohësisht dhe Amrushit, unë e di që mësimdhënës kanë uniformë në xhimnaz dhe e di që është një rregull e punës që bëhet, por prap do ta përcjelli si kërkesë do të diskutoj dhe me Drejtorin e shkollës do të sjellim mundësi të i paisim nxënësit me uniforma. Por mendoj që në këtë kohë të rritjes së qmimeve me kërku uniformë nga prindërit është problematike.

Labi e ceku kur do të hapet qerdhja, jemi në finalizim. Në sa shkolla kemi Drejtoresha e bëri dikush këtë pyetje, janë 5 Drejtoresha me të cilat unë ndihem mirë për punën e tyre me disa prej tyre jo shumë mirë për

arsye të mungesave të cilat i kanë në institucionet shkollore kjo nuk është nga dëshira e tyre por si rezultat që i kanë fëmijet e vogël. Lajmi më i fuqishëm dhe më i gëzueshëm është furnizimi me bursa të këtyre studentëve të cilët kanë pasur kërkesa në drejtim të komunës së Malishevës. Mendoj që është një nga vendimet më të mira dhe më të dëshiruara të Kryetarit Kastrati në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit. Të gjithë ata student të cilët janë përfitues të bursave janë të Universiteteve Publike. Statusi në publik ka qenë i publikuar me 3 shtator që me ja fillu mësimi dhe ne e kemi bërë kërkesen në drejtim të mësimdhënësve dhe të gjitha institucioneve me kohë, nuk ka qenë as data 7 apo 10 por ka qenë data 3 shtator. Librat janë shpërnda me vones është e vërtet dhe diskutimin me ministrin e arsimit e kemi pasur sepse është një përshtypje e imja që është krijuar një monopol me shtëpit botuese. Për komunën e Malishevës ju e dini që janë në fuqi dy shtëpi botuese janë dy monopole që janë kriju pikërisht me ndihmen e ministrit të Arsimit. Këto shtëpi botuese i kanë shpërnda librat me vonesë. Mungesa e librave nuk është qështje e jona sepse është qështje e shtëpive botuese me marrveshjen që e ka bërë ministria e arsimit me ta.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!.

Alban Kastrati: Të përgëzoj Drejtoreshë për raportin e juaj, unë dëshiroj ta bëjë një pyetje te shkolla në fshatin Damanek në vitin e kaluar ka ra në një klas pllafoni ka pasur dhe nxënës në atë klas a keni ndërmarrur ndonjë hapë a është renovuar ajo klasë apo e keni në proces në kuadër të këtij projekti që e keni për renovimin e shkollave?

Arbëresha Krasniqi: Alban, faleminderit për pyetjen, nuk ka pasur lëndime të fëmijëve në atë klas ku ka pasur dëmtim të pllafonit. Drejtorja e Urbanizmit e ka bërë punën e vet në kohë dhe ajo pjesë është rregulluar.

Argjend Thaçi: E përmbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës e cila ishte pika 3. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së, për përgaditjet dimërore nëpër shkolla. Faleminderit Drejtoreshë. Pika e radhës është: 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të Kryetarit për ndalimin e shërbimit me shishe (SHISHE-LLula, Nagril e të ngjashme në largësi 500m nga objektet shkollore dhe nga 400m nga Stacioni i Autobusëve. Sipas specifikave të cekura më poshtë: Të nderuar anëtar të kuvendit të komunës bazuar në gjendjen aktuale në qytetin e Malishevës kërkoj që të shqyrtohet kjo kërkesë, e cila ka të bëjë me ndalimin e shërbimit me shishe dhe në lokalet afëriste, gastronomi dhe të ngjashme në teritorin e komunës së Malishevës afër shkollave dhe stacionit të autobusëve sipas specifikave në vijim: Me largësi ajrore me distanc jo më afër se 500m afër objekteve shkollore. Në largësi ajrore në distanc jo më afër se 400m afër stacionit të autobusëve. Pas miratimit të kësaj kërkesë vendimit në fjalë do të nështrohet konfirmimi i ligjshmërisë pastaj drejtorja për inspektoriat do ta dorëzojë për zbatimin e të njëjtit konform dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës. Urdhëro Amrush Helshani e ka kërkuar fjalën!

Amrush Helshani: Faleminderit Kryesues, shisha e njohur ndryshe si nargjilja është kthyer në trend për të rinjtë në vend. Këti trendi nuk po i shkon as të miturit, as adoleshentët dhe as të rinjtë të cilët me përdorimin e saj po mendojnë se po ndihen mirë. Ky fenomen i ekspozon ata ndaj lëndëve kancerogjene

dhe varësis ndaj një kulture orientale e të qendruarit në grup për orë të tëra në tym. Se çka përmban shija e shishës në vete është pikëpyetje e madhe, dhe sigurisht që inspektoriati komunal kanë përfunduar kontrollat e tyre në këto lokale që i shërbejnë këto produkte. Nëse ndalemi dhe hulumtojmë se çka në të vërtetë është ky produkt është një proces i tymosjes së duhanit me shije i cili realizohet ndërmjet djegies së qymyrit dhe ftohjes së tymit nga uji, shijet janë të ndryshme duke filluar nga më të butat deri në ato më të fortat. Nga dëshmit e të rinjëve të cilët e përdorin simptomat të cilat ju shfaqen janë: Marramendje, humbje e munitetit, ulje tensioni, problem me mushkëri. Pra direkt rrezikim i shëndetit të të rinjëve të cilët i përdorin këto. Unë dua të cekim një rast nga përvoja e punës në qendren e rinis në të kaluarën ka pasur shumë raste ku të rinjtë e komunës së Malishevës i kemi ftuar në aktivitetet të ndryshme rinore, dhe shpesh kemi pasur problem për pjesëmarrje në aktivitete. Ndërsa gjithmonë shisha baret kanë qenë të mbushura plotë me të rinjtë të shkollave të mesme në lokale me muzik dhe të mbushura me tym. Jamë për ndalimin e shishave në lokalet që janë afër shkollave dhe stacionit të autobusëve.

Argjend Thaçi: Faleminderit Amrush, urdhëro Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Po ndërlidhna me kolegun që na tregoj disa efekte negative për përdorimin e këtyre shishave, dhe në këtë rast kërkesa që është ardh nga Kryetari më duket e pa arsyeshme sepse Kryetari e ka cek në largësi ajrore në distanc jo më afër se 500m afër objekteve shkollore dhe në largësi ajrore në distanc jo më afër se 500m afër stacionit të autobusëve. Nëse janë këto shisha aq të dëmshme në efektin e të rinjëve që i përdorin atëher mendoj që kërkesa do të duhej të na vinte për ndalimin e të gjitha lokaleve të shisha barëve.

Argjend Thaçi: Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Një debat që e kemi pasur në KPF me drejtorin, shefin e inspektoriatit dhe Muharremin që ishte prezent. Ne kemi kërkuar që me marrë mendim nga komunat e tjera dhe kanë thënë që e kanë marrë Gjakovën si model që e kanë ndal një veprimtari të tillë, sepse nëse nuk ka bazë ligjore kjo kërkesë mundet me u bë e jashtëligjshme, bjen ndesh me ligjin për veprimtari biznesore. Përndryshe ky fenomen ska diskutim që duhet të ndalet që janë pranë shkollave dhe stacionit të autobusve. Si vërejtje kam kërkuar që si shtes të kësaj kërkesë të paktën të futet dhe ndalja e zërimit të madh të këtyre lokaleve që janë afër shkollave dhe te stacionit, kemi shumë zhurmë të madhe të muzikës.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Faleminderit Kryesus! Ajo që desha ta them e ceku dhe Vetoni është pjesa e zërimit ku këto biznese përveq shërbimit të shishave kanë dhe lloje të tjera që shërbejnë. Por pengesa ndër më të mëdhatat ka qenë dhe pjesa e mos kontrollës së zërimit. Kjo përveq që i ka penguar njerëzit që kanë kaluar andej, i ka penguar dhe personat që e ushtrojnë biznesin afër tyre, njëkohësisht muzika që është përdorur nuk ka qenë një mundësi e duhur kanë lëshuar muzika më demigruese për shoqërin tonë që janë. Kjo ka ndikuar negativisht te bizneset tjera. Si veprimtari lejohet me ushtru, ky vendim i joni letë jetë në harmoni me ligjin e nivelit qëndror. Po ashtu pajtohna me një pjesë të Valon Krasniqit që tha nëse duhet me i ndalu po i ndalojmë të gjitha. Këto shisha baret nuk kanë ndonjë leje të veçant për me shërby kanë vetëm leje si furnizues me qenë, mirëpo a lejohet apo nuk lejohet nuk e di, është mirë që Drejtoria e

inspektoriatit me shqyrtu dhe me u harmonizu me ligjin e Ministris së Tregtisë a lejohet me i ndalu na apo nuk lejohet. Përndryshe kjo si dukuri është negative për shëndetin e shoqëris sonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Unë pajtohem plotësisht me mendimin që dhanë kolegët është mirë me shiqu se a cenohet ligji apo është në përputhshmëri, dhe do të ishte mirë që me e eliminu krejt si dukuri. Është shumë shumë shqetësuese, sepse më shumë po i pengon nxënësit e xhimnazit dhe kërkes e jona është me ndalu krejt këtë veprimtari.

Argjend Thaçi: Urdhëro Mirë lindë Gashi!

Mirë lindë Gashi: Te propozim vendimi pika parë shënon: Ju ndalohet të gjitha subjekteve afariste , pastaj ka dalë në A dhe B ku i ka specifiku vetëm këto afër shkollave dhe stacionit të autobusëve. Këtu kërkojmë një sqarim.

Valon Mazreku: Profesoresh këtu është propozim vendim dhe ju ka referu ligjit për vetqeverisje lokale ku i tregon kompetencat e Kryetarit. Dhe ligji i vetqeverisjes lokale mundet me qenë në kundërshtim me ligjin e tregtis dhe ministris së tregtisë. Këtu ka tregu për kompetencën e Kryetarit.

Argjend Thaçi: Urdhëro Arlind Morina!

Arlind Morina: Sa i përket kësaj pike dhe unë jam kundër këtyre aktiviteteve së fundi këto aktivitete kanë fillu të shfaqen dhe nëpër fshatra jo vetëm në qytetin e Malishevës. Dhe nëse marrim një vendim kërkoj nga Inspektoriat i që të zbatohet vendimi me të vërtet.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Unë me sa kam njohuri për këto shisha nuk sjellin dëme, inspektoriat i është mirë me kriju grupe të ndryshme me monitoru që nxënësit tonë mos të përdorin gjëra të tjera. Sa i përket dëmit munden dhe me pyt jo vetëm inspektoriat i por mundemi me pyt dhe mjek apo persona që e njohin këtë fushë.

Argjend Thaçi: Urdhëro Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Në këtë rast kërkesa e Kryetarit duhet me u mirëkuptu që të paktën me u mundu me i largu nga dyert e shkollave këto dukuri që janë jo të mira. Unë nuk kam përdor por kamë parë në një emision që pothuajse shisha është e dëmshme ngajshëm sikurse duhani, sepse krijonë varësi. Fjala është me u ndal shërbimi me shisha jo me u mbyll lokalet.

Argjend Thaçi: Nën Kryetari e ka fjalën!

Vesël Krasniqi: Unë konsideroj që kjo pikë e rendit të ditës është shumë e rëndësishme, shqetësimi jonë ka ardhur prej shumë ankesave nga prindërit. Kryetari nuk i ka inat asnjë subjekti afarist që e ushtron këtë

veprimtari. Por arsyeja është nga shqetësimet e shuma nga ana e prindërve. Është një dukuri e ligjshme por kjo krijon varësi, te moshat ligji e ndalon është e përcaktume me ligj se cila moshë duhet me përdor. Inspektoriati ka has në mosha të cilët nuk duhet ta përdorin. Kjo nuk është e drejtë që ne mundemi me ndalë si veprimtari, por ne kemi të drejtë si asamble komunale që renin e mbrendshëm me e rregullu vetë. Shqetësimi është te nxënësit dhe për këtë arsye është kërkuar që distanca nga objektet shkollore dhe të stacionit të autobusëve të këtyre lokaleve të jetë e largët që mos ta shfrytëzojnë pauzën duke i frekomanduar këto lokale sepse kështu krijohet dhe varësi. Të paktën ne si përgjegjës të institucioneve është mirë që shqetësimet e prindërve të i marrim, pa dashur të dëmtohet asnjë biznes.

Argjend Thaçi: Faleminderit Nënkryetar, urdhëro Drejtor i Inspektoriatit e ka fjalën!

Hafir Rexha: Përsëndetje për të gjithë! E potencoj dhe nënkryetari që ky është një rregullim i mbrendshëm, ne kemi kontaktuar dhe me organet e inspektoriatit të Komunës së Gjakovës. Përveq që kanë marrë vendim nga kuvendi ata e kanë futur dhe në rregullore të posaqme, por e kanë bërë me një largësi më të afërt me një modernitet që nënkupton që të gjitha shisha baret janë jashtë qytetit të Gjakovës. I kanë bërë me distanc 50m por në 50m i kanë shti objektet banesore, institucionet fetare, institucionet shkollore. Ne si inspektoriat gjatë inspektimeve tona e kemi vërejt që në objektet afër xhimnazit dhe kjo është njëra nga faktorët që fëmijet tanë hezitojnë të shkojnë në shkollën e Kompetencës. Ne si inspektoriat kemi vlersu dhe ju kermi drejtuar Kryetarit me një Kërkes dhe i kemi bërë matjet rrugore gjë që ne kërkojmë nga ju që ta mbështesni këtë propozim. Dhe Vetoni e ceku zërimin e tepërt kjo është e ndaluar dhe me ligj, ne si inspektoriat do të marrim masa.

Argjend Thaçi: Urdhëro Hamit Lima!

Hamit Lima: Përsëndetje për të gjithë! Ky propozim vendimi dhe nga ana ime është i mirëpritur ne në KPF kemi diskutu, unë kam kërkuar nga kjo distanc të bëhet dhe ndalimi i shitjes për shumë arsye. Nëse lejohet shitja prap kanë me ble dhe do ta përdorin në një kafe tjetër. Kam kërkuar të ndalohen dhe afër institucioneve të tjera siq janë Xhamia dhe Komuna.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Unë jam i pajtimit që me u specifiku moshat sepse nën moshën 18 vjeqare asesi mos me u leju, por nuk jam me kalu 100% sepse ne mbas një muaji rinia jonë do të shkojë në lokale në Suharek, Rahovec, Drenas.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim pikën 4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të Kryetarit për ndalimin e shërbimit me shishe (SHISHE-Llula, Nagril e të ngjajshme në largësi 500m nga objektet shkollore dhe nga 400m nga Stacioni i Autobusëve. Kush është për?

Për: 25

Kundër: 1

Abstenim: 0

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e radhës që është:

5.

Shqyrtimi i kërkesës nr.02/252 datë:23.05/2022 të parashtruar nga Besnik Bytyqi, për lejimin e ndërtimit

të rrethojave të varrezave në fshatin Shkozë. Kjo është pikë e rendit të ditës e bartur nga seanca e kaluar shefat e grupeve janë paisur me disa nënshkrime të cilat i ka sjell bartësi.

Urdhëro Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Po ndërlihdna me kërkesen në fjalë nuk e di se si KPF po i lejon disa gjëra pa i shqyrtu dhe pa i respektu disa procedura. Në seancen paraprake kemi thënë që kërkesa në fjal për me qenë valide dhe me shqyrtu ne duhet me ardhë e nënshkruar nga kryesia e fshatit ose me bë një petition nga banorët e ati fshati. Unë konsideroj që kjo kërkes nuk duhet as me u shqyrtu.

Argjend Thaçi: Urdhëro Arlind Morina!

Arlind Morina: Sa i përket kësaj pike unë e kam dhënë mendimin tim dhe në seancen e kaluar, ne e mbështesim këtë pikë duke e ditur që investimet janë duke u bërë me të hyra vetanake. Unë kam pasur rastin të bisedojë me personin që e ka bërë kërkesen ku i ka sqaru shum detaje ku do të ndërtohet ai muri. Inspektoriati ka dalur dhe ka vërtetu që nuk është penges për askënd dhe i ka dhënë konstatim që mundet me i vazhdu punimet. Ne duhet ta mbështesim dhe duhet përgëzuar për punën që është duke e bërë sepse është një vlerë e madhe dhe është duke e bërë me të hyra vetanake. Ne si grup e mbështesim këtë kërkes.

Argjend Thaçi: Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Nuk ka dyshim që ne i kemi kërkuar opinionin e dy palëve, dhe kryesia fshatit me na sjell një arsyetim pse janë kundër rrethimit të varrezave. Ppo ashtu kemi kërkuar nga pala që e ka bërë kërkesen që ta sjellë një petition dhe ky realisht nuk i letëson kriteret si një listë e nënshkrimeve. Po nga gjithë këto meqë Drejtoria e Gjeodezis pasi që u dal në teren dhe ka parë që ai muri që ka filluar të bëhet nuk është penges për qytetarët, nëse qëllimi është i mirë në shërbim të komunitetit për me i rrethu varrezat nuk po e shoh ndonjë problem që të mos bëhet ajo punë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Ne i kemi dhënë disa këshilla parashtuesit të kërkesës me e bë një petition, mirëpo lista që na ka ardhur nuk i plotëson kriteret me u quajtur si listë e nënshkrimeve, sepse mungojnë të dhënat. Është pak dilem se qfar të bëjmë me këtë kërkes sepse personi në fjal e ka lëshuar pronën e vetë private, po dëshiron me i rretheku varrezat por kryesia e fshatit janë kundër.

Argjend Thaçi: Urdhëro Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Atë që pata me e thënë e thanë parafolësit ne të paktën ja kemi kërkuar mendimin se përse kryesia e fshatit është kundër, të paktën të e sillte listën e nënshkrimeve në baz të kriterëve. Mos po e nxisim një konflikt pa dëshiren tonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Unë dua të cekim vetëm tri arsye nëse do të votoj kundër. Na ka ardhur një petition jo vetëm që është i përgjysmuar por mendoj që është realizu dy deri në tri familje. Kryetari dhe Kryesia e

fshatit në fjalë janë zgjedhur në mënyr legjitime përmes Komisionit dhe përmes antarëve të kuvendit komunal në Malishevë. Qështja e pronës që e ka lëshuar me dëshirën e tij, por qka nëse pas 20 vitev bëhet një investim dhe ai me anën ligjore prona është e ti. Unë mendoj kështu që së pari të rregullohet qështja e pronës që ka bërë një veprim të mirë, dhe të na sjellë një listë me nënshkrimin apo me një peticion më bindës po ashtu është mirë që mos ta përfill kryetarin dhe kryesin e fshatit.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim pikën 5. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/252 datë:23.05/2022 të parashtruar nga Besnik Bytyqi, për lejimin e ndërtimit të rrethojave të varrezave në fshatin Shkozë. Kush është për?

Për: 13

Kundër: 9

Abstenim: 3

Me 13 vota për, 9 kundër, 3 abstenime aprovohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është 7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/467 datë:10.10.2022 e parashtruar nga Avdullah Bytyqi nga fshati Turjakë. Me leje të parashtruesit të kësaj kërkesë, kërkoj që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës. Kush është për?

Me vota unanime, konsideroj që largohet kjo pikë nga rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: 8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/470

datë:11.10.2022 e parashtruar nga Dardan Zogaj nga fshati Lladroc

Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: në KPF e kemi pyetur dhe Drejtorin për politik dhe financa se a ka mjete të mjaftueshme që të ndihmohen këto kërkesa dhe përgjigjia ka qenë që nuk ka mjete. Vetëm me mbështet financiarisht dhe në kohën kur ka buxhet komuna me mbështet nuk kam ndonjë propozim për shumën.

Argjend Thaçi: Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Meqë janë dy raste të njëjta me sëmundje të njëjta ja ndajmë 2000E dhe kur do që Drejtoria e financave të ketë mjete të ja qet.

Argjend Thaçi: Urdhëro Burim!

Burim Paqarizi: Së pari uroj që Dardani ta kaloj këtë sëmundje sa më lehtë dhe sa më shpejt. Unë pajtohem me mendimet e kolegëve që dhe pse na tha Drejtori që nuk kemi financa ne ti ndihmojmë dhe kur do që të i dhurohet mundësia të i bëhet pagesa. Ne e mbështesim këtë kërkesë.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon!

Valon Mazreku: Gjitha kërkesat që janë të kësaj kategorie të cilat sjellen në kuvend ne nuk mundemi me hesht kundrejt këtyre kërkesave. KPF duhet me u dakordu për financat dhe duhet me i marrë të gjitha informatat sa i përket buxhetit. Nëse nuk ka buxhet duhet me i stopu ose me i ndal kërkesat në momentin që vjen këtu kot na thot Drejtori që nuk kemi mjete. Unë e mbështes propozimin e Halilit.

Argjend Thaçi: Urdhëro Arlind Morina!

Arlind Morina: Unë pajtohem me fjalën e Valon Mazrekut, i cili tha që nëse vjen me rekomandimin e KPF-së duhet të gjinden financa nga Drejtoria përkatëse, ne e mbështesim këtë kërkesë dhe shumën që u dha.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Dhe unë jam pro e kësaj kërkesë.

Argjend Thaçi: Urdhëro Labinot Gashi!

Labinot Gashi: I ndëgjova të gjithë parafolësit me vëmendje, i uroj shërim të shpejt kërkoj nga KPF që të gjitha të trajtohen njëjt, sepse kanë ardhur dhjetra kërkesa të natyrës së njëjt dhe nuk kanë ardhur në kuvend. Dhe drejtor duhet me ardh me një shumë të caktuar në bazë të kushteve buxhetore që janë. Unë në këtë pikë abstenoj.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/470 datë:11.10.2022 e parashtruar nga Dardan Zogaj nga fshati Lladroc për ndihmë financiare që ti ndahen 2000E.

Kush është Për?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenuim: 2

Kalon kjo pikë e rendit të ditës .

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: zëvendësimi i antarit të komitetit të urbanizmit. Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Ne kërkojmë që në komitetin e Urbanizmit antari i tanishëm Driton Morina të zëvendësohet me Agnesë Kastrati.

Argjend Thaçi: Kush është për?

Me vota unanime e konsideroj që është aprovuar dhe kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me Zëvendësimin e antarit të Komitetit të Diasporës Zanfina Bashota me Meriton Bashotën.

Kush është për?

Me vota unanime, aprovohet kjo pikë e rendit të ditës.

Këtë seancë e shpalli të mbyllur. Faleminderit për prezencën.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi, Kuvendit
Argjend Thaçi

